



Funded by  
the European Union



MNE-ALB  
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

## **THIRRJE PËR APLIKIM PËR PËRZGJEDHJEN E MENTORËVE PËR OFRIMIN E TRAJNIMIT PËR SIPËRMARRJE PËR TË RINJTË (GRUPMOSHA 15-29 VJEÇ) DHE GRA TË PAPUNA NË ZONËN E BASHKISË SHKODËR, BASHKIA VAU I DEJËS DHE BASHKIA MALËSI E MADHE.**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të zbatimit të projektit “Aftësi për Punësim të Qendrushëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi”, “Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri 2014 – 2020”, nën Instrumentin Për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II), financuar nga Bashkimi Evropian, shpall thirrjen për mentorë të interesuar për ofrimin e shërbimit të trajnimit me qëllim aftësimin për krijimin e planeve të biznesit dhe fillimin e një biznesi, për të rinjtë (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna, në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe.

### **A. THIRRJA KA NË FOKUS OFRIMIN E DY SHËRBIMEVE NGA ANA E MENTORËVE:**

1. Ofrimi i trajnimeve me njohuri bazë dhe përgatitja e një manuali me udhëzime për 15 pjesëmarrës që do të zhvillojnë plane biznesi dhe do të fitojnë njohuritë e nevojshme për të filluar biznesin e tyre, në fushat si më poshtë:

- Aspekte ligjore dhe regjistrimi i biznesit
- Menaxhimi financiar dhe kontabiliteti
- Planifikimi strategjik dhe krijimi i modelit të biznesit
- Marketingu dhe shitjet
- Marketing dixhital/ përmbajtje

Numri i përgjithshëm i ofruesve të shërbimeve të mentorimit është 5 (pesë). Çdo ofrues i shërbimit të mentorimit do të ofrojë trajnime në fushën profesionale që ai mbulon në kohëzgjatje prej 2 (dy) ditësh.

Buxheti i parashikuar për ofrimin e këtij shërbimi nga mentori është 300 euro bruto, për një ditë trajnimi, në total 600 euro bruto. Shuma përfshin çdo lloj shpenzimi që lidhet me ofrimin dhe kryerjen e këtij shërbimi (transport, akomodim).



Funded by  
the European Union





2. Trajnime individuale mentorimi: Secili mentor duhet të ofrojë trajnime nga fusha e tij e ekspertizës që mbulon, me secilin nga 15 pjesëmarrësit që duhet të zhvillojnë dhe krijojnë planet e tyre të biznesit, për një kohëzgjatje prej 20 (njëzet) orë për pjesëmarrës/ të trajnuar, për fushat si më poshtë:

- Aspekte ligjore dhe regjistrimi i biznesit
- Menaxhimi financiar dhe kontabiliteti
- Planifikimi strategjik dhe krijimi i modelit të biznesit
- Marketingu dhe shitjet
- Marketing dixhital/përmbajtje

Buxheti i parashikuar për ofrimin e këtij shërbimi nga mentori është 100 euro bruto, për çdo pjesëmarrës, për një total prej 1500 euro bruto për 15 pjesëmarrës. Shuma përfshin çdo lloj shpenzimi që lidhet me ofrimin dhe kryerjen e këtij shërbimi (transport, akomodim).

## B. DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

Në rastin e individit aplikues, aplikimi duhet të përmbajë:

1. Formularin e aplikimit, të firmosur, që mund ta shkarkoni në linkun: [Link](#)
2. Diplomë që vërteton arsimin e kryer në fushën për të cilën aplikoni
3. Curriculum vitae (CV) e individit aplikues, ku të tregohet qartë përvoja, eksperiencia në shërbime të ngjashme, shoqëruar me dokument identifikimi (kartë identiteti dhe/ose pasaportë)

Në rastin e subjekteve juridikë tregtarë, aplikimi duhet të përmbajë:

1. Formularin e aplikimit, të firmosur, që mund ta shkarkoni në linkun: [Link](#)
2. Kopje të ekstraktit historik të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga momenti i aplikimit
3. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT).
4. Curriculum vitae (CV) të individit/individëve që do realizojnë trajnimet, shoqëruar me dokument identifikimi (kartë identiteti dhe/ose pasaportë)
5. Diplomë që vërteton arsimin e kryer në fushën për të cilën aplikon, të individit që do ofrojë shërbimin e kërkuar.





Funded by  
the European Union



Në rastin e subjekteve aplikues, organizata jofitimprurëse, aplikimi duhet të përmbajë:

1. Statuti, Akti i Themelit dhe të gjitha Vendimet e Gjykatës të organizatës që nga momenti i
2. themelimit deri në datën e publikimit të kësaj Thirrje (kopje të noterizuara).
3. Ekstrakti i Gjykatës (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë) - original brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit.
4. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT).
5. Vërtetim që organizata është me status aktiv në momentin e aplikimit.
6. Curriculum vitae (CV) të individit/individëve që do realizojnë trajnimet, shoqëruar me dokument identifikimi (kartë identiteti dhe/ose pasaportë)
7. Diplomë që vërteton arsimin e kryer në fushën për të cilën aplikon, të individit që do ofrojë shërbimin e kërkuar.

Do të preferohen kandidatët për mentorë, të cilë zotërojnë njohuri, përvojë/eksperiencë në realizimin e trajnimeve të ngjashme. Përparësi do të kenë aplikuesit me përvojë të mëparshme në të tilla trajnime (3-5 vjet) me të rinj dhe gra, të vërtetuara përmes kontratave ose çdo dokument tjetër që vërteton eksperiencën.

Të interesuarit duhet të dërgojnë aplikimet e tyre në pranë zyrës së Arshivë – Protokollit, pranë AIDA-s, në adresën: Rruga “Skerdilajd Llagami”, Ndërtesa nr.1, H.6, Tiranë, ose në adresën elektronike të e-mailit [info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al), jo më vonë se data 18 mars 2024, ora 16.30. Aplikimet e dorëzuara përtej datës dhe orës së përcaktuar, nuk do të merren në shqyrtim.

Individët që do të përzgjidhen fitues, duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e mësipërm në gjuhën shqipe, original ose kopje e noterizuar.

Për çdo pyetje/sqarim në lidhje me këtë thirrje, mund të kontaktoni në adresën elektronike të AIDA-s, [info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al).

Tiranë, 22.02.2024



Funded by  
the European Union

